



Pranuar / Dostiguar Received/Delivered	06-05	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Dr Prot Dr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	2646/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.278/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.278/2022 të datës 23.03.2022 të parashtruar nga ankuesi i madh Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-ngritje e koeficientit", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 04.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.278/2022 e datës 23.03.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut sipas Akt Emërimit të datës 10.07.2019 në pozitën "Zyrtar për ndriçim publik", në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, më datë 13.01.2022 ka parashtruar kërkesë për harmonizim të koeficientit tek Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, të cilën kërkesë udhëheqësi i drejtpërdrejtë gjegjësisht Udhëheqësi i Sektorit të Shërbimeve Publike më datë 20.01.2022 e ka përcjell tek Zyra e Personelit e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke kërkuar që ankuesit t'i mundësohet harmonizimi i koeficientit nga gjashtë (6) në shtatë (7).

Menaxheri i Personelit i Komunës së Mitrovicës së Jugut, më datë 07.02.2022, përmes përgjigjes ka njoftuar Udhëheqësin e Sektorit për Shërbime Publike se pozita që mban në bazë të katalogut të vendeve të punës është sipas gradës 10 dhe koeficienti i kësaj pozite është gjashtë (6), ndërsa nëse do të ishte grada 9 me të drejtë do të kërkonte harmonizimin e koeficientit sipas gradës, ndaj i njëjti është i harmonizuar sipas gradës dhe koeficientit.

Në bazë të fletë-dorëzimit Udhëheqësi i Sektorit për Shërbime Publike, përgjigjen e Menaxherit të Personelit e ka pranuar më datë 09.02.2022.

Ankuesi përmes postës më datë 21.03.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër R 2093478, e cila më datë 23.03.2022 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe është regjistruar me numër të ankesës A.nr.278/2022 me Nr.Prot:1552/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.03.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Këshilli, me datë 14.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:1552/2022 të datës 23.03.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës së Kosovës , pliko e datës 21.03.2022 me numër R 2093478; Akt Emërimit të datës 10.07.2019; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 16.04.2019; Struktura organizative; përshkrim i punës i nxjerr nga SIBMNJ i datës 21.03.2022; Kërkesën për harmonizim të koeficientit nga ankuesja e datës 13.01.2022; Arsyetim për harmonizim të koeficientit i datës 20.01.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 07.02.2022 nga Menaxheri i Personalit; Përgjigjen në ankesë e datës 14.04.2022; E-mail i datë 22.04.2022; E-mail i datës 12.04.2022; Vendim Anr.193/2022 i datës 07.04.2022 i KPMSHCK-së; Lista e pagave nga data 01.02.2022 deri me datës 28.02.2022; Lista e pagave nga data 01.03.2022 deri me datës 31.03.2022; Shpallja e rekrutimit i datës 25.04.2019; Konfirmim për mjetet financiare të datës 21.03.2019; fletë-dorëzimit i datës 09.02.2022;Organogramin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë; kërkesë për provë shtesë E-mail i datë 26.04.2022; Përgjigje e datës 26.04.2022, me E-mail.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Në bazë të provave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesi përgjigjen e datës 07.02.2022 për kërkesën e datës 13.01.2022, e ka pranuar me datë 10.02.2022 sipas njoftimit nga Udhëheqësi i Sektorit për Shërbime Publike, i cili me datë 09.02.2022 e ka nënshkruar fletë dorëzimin e datës 07.02.2022 me nr.01-120/04-003179-2/22, për pranimin e përgjigjes në kërkesë të datë 13.01.2022 nga Menaxherit të Personelit, për të cilën ankuesi dhe Udhëheqësi i Sektorit për Shërbime Publike është deklaruar përmes e-mailit të datës 26.04.2022 pasi që Zyrtarja për bashkëpunim profesional në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për këtë lëndë, ka kërkuar përmes e-mailit të datës 26.04.2022.

Lidhur me këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se përgjigjja e datës 07.02.2022 e Menaxherit të Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut nuk ka udhëzim juridik, në kuptim të nenit 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj”*, ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është e afatshme dhe e pranueshme në kuptim të afatit, sipas nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me harmonizimin e koeficientit nga koeficienti gjashtë (6) në koeficient shtatë (7), dhe ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara në ligj, sepse në bazë të dëshmive të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ankuesi është punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut përmes procedurës së rekrutimit respektivisht përmes konkursit të jashtëm të shpallur me datën 25.04.2019, për pozitën e lire të punës „ Zyrtar për Ndriçim Publik”, me koeficient gjashtë (6) në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, me numër të referencës JP00038842. Kolegji për shqyrtimin e ankesave po ashtu ka konstatuar se pas përfundimit të procedurës së rekrutimit Komuna e Mitrovicës së Jugut i ka ofruar ankuesit Aktin e emërimit për nënshkrim me kushtet e punësimit për këtë pozitë, ku njëra ndër kushtet ka qenë edhe koeficienti gjashtë (6) të cilin akt emërimi ankuesi e ka nënshkruar me datë 12.07.2019 për pozitën „ Zyrtar për Ndriçim Publik”, në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë.

Bazuar në dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil*, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës*, Kolegji ka konstatuar se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Andaj, mbi këtë bazë ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht në baze të listës së pagave, Kolegji ka gjetur se ankuesi e realizon pagën sipas Akt Emërimit pa afat të datës 12.07.2019 respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut kompensimin e pagës së ankuesit e bene ashtu siç është është paraparë me aktin e themelimit të marrëdhënies së punës gjegjësisht ankuesi e realizon të drejtën e pagës sipas koeficientit gjashtë (6).

Neni 7, paragrafin 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, përcakton se, *„ Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat”* andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton



se harmonizimi i koeficienteve bëhet nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, në këtë kuptim ligjërish ngritja apo harmonizimi i koeficientëve për nëpunësit civil, mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurave ligjore e që duhet dëshmohet se institucioni ka planifikuar mjete buxhetore të miratuara nga ministria përgjegjëse për administratë publike respektivisht ministria përgjegjëse për financa, andaj përderisa nuk ka planifikim të buxhetit apo nuk ka kërkesë nga institucioni ku nëpunësi civil është duke e ushtruar pozitën tek institucionet gjegjëse, nëpunësi civil paguhet me pagë siç është përcaktuar në aktin e emërimit me të cilin ka themeluar marrëdhënien e tij të punës, siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, respektivisht nenin 9 paragrafin 1 ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”*, si dhe nenin 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave”*, andaj mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit për ngritje të koeficientit në mënyrë automatike pa i ndjekur procedurat e lartcekura është i pabazuar, ngase ngritja apo harmonizimi i koeficienteve nuk është në kompetencë të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.278/2022

Zyle Millaku GOJNOVCI
Zyle Millaku
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI
Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

